

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurit A.B, nga Prishtina, për shkak të veprës penale Heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6223/2017, të dt:20.02.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrin ndëshkimor PP.II.nr.6223/2017, të dt:20.02.2018, më **11.04.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6223/2017, të dt:20.02.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

A.B, nga i ati B, e ëma Xh, i lindur me datë..., në P., me vendbanim në lagjen P. Rr.”S.K”, në P., me numër personal ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 24.09.2017, është konstatuar se në lokalit e tij “D.B”, në Rr.”N.T”, në F.K, i pandehuri ka këputur shiritat e vendosur nga inspektorët komunalë të ndërtimit në F.K dhe ka angazhuar punëtorë për kryerjen e punimeve në lokal edhe pse një gjë e tillë i është ndaluar me procesverbalin nr.59/17, të datës 06.09.2017, të inspektoriatit të ndërtimit për ndalimin e punimeve;-

Me këtë ka kryer veprën penale, Heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit A.B i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **A.B** dënohet me gjobë në shumë prej **400.00 € (katër qind euro)**, të cilin dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale për paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

I dëmtuari: Inspektoriat Komunal i Ndërtimit në Fushë Kosovë, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në kontest të regullt civilo – juridik.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.6223/2017, të dt:20.02.2018, ka akuzuar A.B, se ka kryer veprën penale – Heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrit ndëshkimor, me arsyetim se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrit ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AE-1093 të datës 27.09.2017, deklarata e të pandehurit e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri A.B, është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Heqja ose dëmtimi i vulave zyrtare ose i shenjave nga neni 414 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Në bazë të nenit 463 par.1 dhe 2, të KPPRK-së, pala e dëmtuar është udhëzuar në kontest civil për realizimin e kërkesës pasurore-juridike.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.881/2018 të dt. 11.04.2018

Procesmbajtësja,
Sanije Troshupa

G j y q t a r i
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE:

Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.